VENDIM
Nr.109, datë 25.2.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 "PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t'i shtohen dhe "18 km" rrugë.
2. Në lidhjen 1 "Rrjeti rrugor kombëtar", që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:

"Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Elbasan, Gostim-Klos-Mollas-Selitë, 18 km rrugë interurbane, dytësore".

3. Në tabelën "Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale", që i bashkëlidhet vendimit, hiqet emërtimi "Gostim-Klos-Mollas-Selitë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano